



Pranimi / Dorezuar Prilbena / Prilobeno Received / Delivroy	14-09-2022	2	viti god year
Organ / Bjesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSHK	5382/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.734/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.734/2022 të datës 25.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me numër 177 të datës 27.07.2022, në çështjen juridike “*Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.734/2022 i datës 25.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “*Profesor-i Asocuar*” në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike më datë 25.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me numër 177 të datës 27.07.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2022 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Akademia e Kosovës për Siguri Publike për përgjigje në ankesë. Më datë 07.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokollit 4966/2022 të datës 25.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e B.G. me numër 68 e datës 27.09.2018; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e B.G. me numër 04 e datës 21.01.2014; Ankesë Kontratë për Kohë të Caktuar e B.G. me numër 6 e datës 27.02.2018; Kontratë Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021; E-mail nga

B.G. për K.J. i datës 14.07.2022; Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës i B.G. me numër 177 i datës 27.07.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.08.2022; E-mail nga T.K. për C.Z. i datës 07.09.2022; Përgjigje në ankesë e datës 07.09.2022; E-mail nga XH.K. për T.K. i datës 07.09.2022; E-mail nga B.G. për XH.K. i datës 20.07.2022; E-mail nga B.G. për K.J. i datës 14.07.2022; Vendim me nr.03/13 i datës 27.03.2008; Ankesë e ankuesit e datës 05.08.2022; E-mail nga XH.K. për T.K. i datës 07.09.2022; E-mail nga XH.K. për B.G. i datës 05.08.2022; E-mail nga XH.K. për B.G. i datës 27.07.2022; Vendim me numër 183 i datës 29.08.2022; Deklaratë për tërheqje të ankesës e ankuesit e datës 01.09.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi _____ më datë 25.08.2022 me numër protokoll 4966/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër vendimit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me numër 177 të datës 27.07.2022 për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit, mirëpo ankuesi më datë 01.09.2022 përmes Deklaratës me numër protokoll 5060/2022 ka bërë tërheqjen e ankesës me numër 581 sipas Formularit të Regjistrimit të Ankesës i cili ka të bëjë me ankesën e datës 25.08.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesi me Deklaratën e datës 01.09.2022 ka tërhequr ankesën e datës 25.08.2022, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.734/2022

Çlirim Zeka
Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Eshref Shabani
Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
- Udhëheqësit të Personelit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

